



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe nenit 51, paragrafi 51.1 të Ligjit nr. 03/L– 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), të dispozitave të neneve 4, 5, 6 dhe nenit 7, paragrafi 3 të Udhëzimit administrativ nr. 03/2014, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë, të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d**, dhe të nenit 44, paragrafi 44.1, shkronja **a** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.01.2018, merr këtë

**VENDIM
PËR
FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

I. Miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si komitet i përhershëm.

II. Komiteti për Politikë dhe Financa ka këtë përbërje:

1. Agim Kuleta, LB, kryesues;
2. Visare Gashi, LVV anëtare;
3. Genc Sherifi, LVV, anëtar;
4. Milot Podvorica, LVV, anëtar;
5. Vala Peshku, LVV, anëtare;
6. Halim Halimi, LDK, anëtar;
7. Agim Gashi, LDK, anëtar;
8. Jeta Rafuna, LDK, anëtare;
9. Blerand Stavileci, PDK, anëtar;
10. Fadil Gashi, AAK; anëtar;
11. Sami Boroci, AKR-AA anëtar.

III. Komiteti si në pikën I të këtij vendimi, është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, si dhe dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditim të brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/05-15228/18, më 18.01.2018



KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta